

## MASAT EDUKUESE TË PARASHIKUARA NË KODIN PENAL DHE ZBATIMI I TYRE NË SHQIPËRI

Enkelejda TURKESHI\*

**Abstrakt:** Në Kodin Penal shqiptar krahas dënimeve penale janë parashikuar edhe masat edukuese, të cilat kanë një natyrë paksa komplekse, pasi ndonëse të dallueshme nga dënimi penal, ato mbeten masa shtrënguese shtetërore. Në këtë punim do të trajtohen disa çështje kryesore lidhur me masat edukuese si karakteristikat e tyre kryesore, personat ndaj të cilëve mund të zbatohen, llojet e tyre shoqëruar edhe me vështrim krahasues, problematika në lidhje me zbatimin e masës edukuese në Shqipëri, parë këto edhe në kuadrin e instrumentave juridikë ndërkombëtarë që përcaktojnë standarte bazë të drejtësisë penale për të miturit, si dhe të ilustruara edhe me raste nga praktika gjyqësore. Nëpërmjet analizës së çështjeve të lartpërmendura synohet jo vetëm nxjerrja në pah e natyrës së veçantë të masave edukuese në kuadrin e ligjit penal dhe rëndësisë së zbatimit të tyre efektiv, por edhe nxjerrja e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve nga pikëpamja legislative dhe institucionale në lidhje me këto masa shtrënguese penale që mund të jepen nga gjykatat shqiptare ndaj fëmijëve ose të miturve që kryejnë vepra penale.

**Fjalët kyç:** Fëmijë, i mitur, interesi më i lartë i fëmijës, masa edukuese institucionale, masa të veçanta mbrojtëse, parimi i proporcionalitetit, vepra penale.

### 1. Hyrje

Në legjislacionin penal shqiptar trajtimin të fëmijëve në konflikt me ligjin i janë kushtuar disa dispozita ligjore, të cilat synojnë përmbushjen e detyrimit kushtetues të mbrojtjes së veçantë të fëmijëve nga shteti.<sup>1</sup> Megjithatë, karakteristikë e legjislacionit penal shqiptar lidhur me fëmijët është se dispozitat ligjore janë të shpërndara në kode e ligje të ndryshme dhe nuk ekziston një ligj i plotë i veçantë, i cili të përfshijë të gjitha çështjet e drejtësisë penale për fëmijët.<sup>2</sup> Po kështu, edhe dispozitat e Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal (KP) mbi fëmijët që kanë kryer një veprë penale gjenden të shpërndara në krerë të ndryshëm të saj. Ndërkohë, masat edukuese janë parashikuar në kreun e pestë, i cili i është kushtuar dënimeve penale.

Shumë shtete, si p.sh. Gjermania, Zvicra, Austria, Belgjika, Franca, apo në rajon Kosova, Kroacia, Maqedonia, dhe Serbia, kanë një ligj të posaçëm për të miturit në konflikt me

\* Enkelejda Turkeshi, pedagoge, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

<sup>1</sup> Në bazë të nenit 54(1) të Kushtetutës fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

<sup>2</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri- Një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri*, Tiranë, 2007, f. 21, 83.

ligjin penal, kurse shtete si p.sh. Hungaria, Lituania, Bullgaria, Sllovenia, Mali i Zi, Armenia minimalisht një kapitull të veçantë në Pjesën e Përgjithshme të Kodit Penal, në të cilin trajtohen gjerësisht edhe masat edukuese që mund të zbatohen ndaj tyre, me të gjithë elementet ose karakteristikat e tyre kryesore. Në lidhje me këtë çështje, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i OKB-së në Komentin e Përgjithshëm 10/2007 mbi *të drejtat e fëmijës në drejtësinë për të miturit*, standartin përkatës ndërkombëtar, të parashikuar në nenin 40 (3) të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>3</sup> e ka komentuar si më poshtë vijon:

Sikurse parashikohet në Nenin 40(3) Shtetet Anëtare do të përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal. [Këto ligje dhe procedura mund të kenë formën] e *kapitujve të veçantë* në pjesën e përgjithshme të ligjit penal material dhe procedural, ose ato mund të bashkohen në një *ligj apo akt të veçantë* mbi drejtësinë për të miturit.<sup>4</sup>

Në këtë kontekst edhe Shqipëria në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët, e cila është një dokument i rëndësishëm, që përfshin politikat e qeverisë shqiptare në fushën e mbrojtjes, zhvillimit dhe garantimit të lirive dhe të drejtave për fëmijët, ndër objektivat specifike në lidhje me reformën juridike dhe masat në ndihmë të fëmijëve ka përfshirë edhe miratimin e paketës ligjore ‘Mbi drejtësinë për të miturit’, si dhe ngritjen e funksionimit e strukturave përkatëse në zbatim të paketës ligjore, ku ndër të tjera përmendet edhe Instituti i Riedukimit për të Miturit, si institucion kryesor për ekzekutimin e dënimeve alternative dhe masave të tjera edukuese.<sup>5</sup>

Aktualisht masat edukuese janë parashikuar në një dispozitë të vetme dhe të përbashkët me masat mjekësore në kreun e pestë të pjesës së përgjithshme të KP, i cili i është kushtuar dënimeve penale. Kjo dispozitë është shumë e ngjashme në vendosjen e saj në KP, me dispozitën përkatëse të Kodit Penal të mëparshëm,<sup>6</sup> ndonëse në këtë të fundit masat edukuese dhe mjekësore përmendeshin në titullin e kreut përkatës<sup>7</sup> duke theksuar në këtë mënyrë dallimin e tyre nga dënimet penale. Megjithatë, përmbajtja e nenit 46 të KP aktual dallon nga ajo e nenit 28 të KP të mëparshëm, veçanërisht pas ndryshimeve në

<sup>3</sup> Kjo Konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1992.

<sup>4</sup> Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 “Children’s rights in juvenile justice”* (CRC/C/GC/10), 2007. Shih: <[http://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/GC10\\_en.doc](http://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/GC10_en.doc)>, aksesuar më 10.08.2010.

<sup>5</sup> Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2006-2010, miratuar me VKM nr. 368, datë 31.05.2005.

<sup>6</sup> Neni 28 i Ligjit Nr.5591, datë 15.6.1977 “Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

<sup>7</sup> Kreu i tretë i Pjesës së Përgjithshme të KP të vitit 1977, titullohej “Dënimet, masat mjekësore dhe edukuese”.

këtë të fundit në vitin 1988,<sup>8</sup> duke iu referuar jo vetëm personave ndaj të cilëve mund të zbatoheshin masat edukuese, por edhe llojeve të masave të parashikuara në ligj.

## 2. Karakteristikat kryesore të masave edukuese

E vetmja ngjashmëri midis masave edukuese dhe dënimeve penale konsiston në faktin se edhe këto sikurse dënimet janë masa shtrënguese shtetërore, pasi ndër të tjera kanë edhe këto karakteristika:

- mund të jepen vetëm nga gjykata ndaj personave që kanë kryer një vepër penale dhe pa pëlqimin ose vullnetin e të interesuarve;<sup>9</sup>
- zbatohen me detyrim nga Policia e Shtetit, nëse nuk ekzekutohen vullnetarisht;<sup>10</sup> si dhe
- kufizojnë disa të drejta dhe liri të fëmijës që vendoset në mënyrë të detyruar në një institucion edukimi, i cili imponon një regjim të veçantë jetese dhe marrëdhënie të kontrolluara me familjen.<sup>11</sup>

Megjithatë, masat edukuese kanë edhe disa karakteristika të tjera, të cilat i dallojnë nga dënimet penale,<sup>12</sup> dhe konkretisht në interpretim të nenit 46 të KP ato paraqiten si më poshtë vijon:

- 1) masat edukuese mund të jepen nga gjykata ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale;
- 2) kanë karakter fakultativ për gjykatën, pasi në bazë të nenit 46 KP gjykata mund të japë masa të tilla, por nuk është e detyruar të bëjë një gjë të tillë për çdo të mitur që përjashtohet nga përgjegjësia penale për shkak të moshës apo që përjashtohet nga dënimi;
- 3) kanë për qëllim edukimin e të miturit dhe si pasojë edhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale prej tij apo saj në të ardhmen;
- 4) nuk kanë afat të përcaktuar në ligj, pra jepen pa afat nga gjykata;
- 5) i nënshtrohen rregullisht rishqyrtimit nga gjykata, pasi në çdo rast kjo e fundit, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj për masën edukuese;

<sup>8</sup> Dekreti nr.7251, datë 15.9.1988 “Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

<sup>9</sup> N.Peza, I.Elezi, G.Gjika, D.Dumi, A. Çela, *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Pjesa e Përgjithshme)*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, 1982, f. 289.

<sup>10</sup> Shih nenin 46 të Ligjit Nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

<sup>11</sup> I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Ribotim, West Print, Tiranë, 2009, f.230; Sh.Muçi, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2007, f. 261,320.

<sup>12</sup> I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2009, f. 229.

- 6) vendimi gjyqësor për masën edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë. Revokimi mund të bëhet kryesisht nga gjykata gjatë rishqyrtimit të detyruar të vendimit të saj pas një viti nga dhënia e tij ose para këtij afati me kërkesën e të interesuarit ose të institucionit të edukimit;
- 7) *nuk kanë pasojë të tjera juridike në statusin e të miturit ndaj të cilit janë dhënë, pra nuk regjistrohen në regjistrin gjyqësor;*
- 8) në KP parashikohet vetëm një lloj mase edukuese, e cila konsiston në vendosjen e të miturit në një institucion edukimi.

### 3. Personat ndaj të cilëve mund të zbatohen masat edukuese

Në bazë të nenit 46 të KP masat edukuese mund të zbatohen ndaj të miturve, të cilët:

- a) përjashtohen nga dënimi; ose
- b) për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Sipas KP të mëparshëm (1977) masat edukuese mund të zbatoheshin edhe ndaj *madhorëve* kur gjykata çmonte se dënimet nuk ishin të përshtatshme,<sup>13</sup> për shkak se kishin kryer vepra penale me rrezikshmëri të pakët shoqërore dhe se më parë kishin shfaqur sjellje të mirë.<sup>14</sup> Në funksion të zbatimit të masave edukuese edhe ndaj kësaj kategorie personash në vitin 1988 në KP u shtuan edhe disa lloje të reja masash edukuese.

Sikurse vihet re nga përmbajtja e nenit 46 të KP për të dy kategoritë kryesore të personave ndaj të cilëve mund të zbatohet masa edukuese e parashikuar në të është përdorur i njëjti term, “i mitur”. Kuptimi i këtij termi, i cili është përdorur edhe në dispozita të tjera të KP, shpesh duke përfshirë edhe fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale<sup>15</sup> nuk është përcaktuar në këtë Kod. Megjithatë, në disa dispozita të tjera vihet re se pas ndryshimeve të vitit 2001 është përdorur edhe termi “fëmijë të mitur”.<sup>16</sup> Ndërkohë, sipas teorisë së të drejtës penale në të drejtën penale shqiptare “i mitur” konsiderohet çdo person i grup-moshës 14-18 vjeç.<sup>17</sup>

<sup>13</sup> Në bazë të nenit 28, paragrafi i parë të KP 1977 masat edukuese jepeshin nga gjykata, *kur çmonte se dënimet nuk ishin të përshtatshme* ose kundër personave, që për shkak të moshës nuk kishin përgjegjësi penale.

<sup>14</sup> N.Peza, I.Elezi, G.Gjika, D.Dumi, A.Çela, *E drejta penale e RPSSH (Pjesa e Përgjithshme)*, 1982, f.292; Sh. Muçi, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, 2007, f.262.

<sup>15</sup> Për shembull në nenin 129 të KP termi “i mitur” përdoret për fëmijët nën moshën 14 vjeç: “Shtytja ose tërheqja e të miturve nën moshën katërmëdhjetë vjeç për të kryer krim...”

<sup>16</sup> Për shembull në nenet 100 dhe 101 të KP.

<sup>17</sup> I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2009, f.100.

Në përgjithësi në legjislacionet e posaçme për të miturit në shtete të tjera personat në ose mbi moshën minimale për përgjegjësi penale deri në 18 vjeç konsiderohen të mitur (juvenile), ndërsa personat nën moshën minimale për përgjegjësi penale konsiderohen fëmijë (children). Sipas Konventës për të drejtat e fëmijës (1989), me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç.<sup>18</sup> Në lidhje me përkufizimin e fëmijës në Shqipëri Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, pas marrjes në shqyrtim të Raportit fillestar të Shqipërisë, në vëzhgimet përfundimtare të sesionit të 38-të ka theksuar mungesën e qartësisë lidhur me statusin e fëmijëve ndërmjet moshës 14-18 vjeç ndër të tjera edhe në fushën e drejtësisë për të rinjtë dhe në këtë kontekst i ka rekomanduar Shqipërisë që të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përkufizuar se kush konsiderohet fëmijë në Shqipëri dhe që legjislacioni ekzistues të rishikohet për të siguruar që të gjithë fëmijët nën moshën 18-vjeçare të marrin mbrojtjen për të cilën ata kanë nevojë dhe që u takon në bazë të Konventës.<sup>19</sup>

Në këtë kontekst, duke iu referuar kuptimit të termit “fëmijë” sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe kuptimit të termit “i mitur” në të drejtën penale shqiptare personat ndaj të cilëve mund të zbatohet masa edukuese e parashikuar në KP mund të grupohen si më poshtë vijon:

- të mitur që përjashtohen nga dënimi;
- fëmijë që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Ndërkohë në bazë të KP, për masat edukuese, të cilat mund të zbatohen edhe ndaj fëmijëve nën moshën minimale për përgjegjësi penale (MMPP), nuk është përcaktuar kufiri më i ulët i moshës nën të cilin masa edukuese nuk mund të zbatohet, ndërsa kufiri më i lartë është i përcaktuar në mënyrë indirekte me mbarimin e miturisë, pra në moshën 18 vjeç. Në shumë shtete të tjera në rajonin e Ballkanit, si p.sh. në Slloveni, Kosovë, Mal i Zi, dhe Kroaci vihet re se legjislacioni përkatës penal parashikon se masat edukuese ose korrektuese mund të zbatohen edhe për kategorinë e personave në moshën 18-21 vjeç (madhorë të rinj), ndonëse sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligj.<sup>20</sup>

Në lidhje me këtë kategori edhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës në Rekomandimin mbi mënyrat e reja të trajtimit të kriminalitetit tek të miturit dhe rolin e

<sup>18</sup> Sipas nenit 1 të Konventës për të drejtat e fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 : “...me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.”

<sup>19</sup> Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës: Shqipëria, sesioni 38(CRC/C/15/Add.249), 28 Janar 2005, <<http://www.mfa.gov.al/>>, akses më 10.08.2010.

<sup>20</sup> Neni 94 i KP Slloven, nenet 9 dhe 10 të Ligjit Penal për të Mitur të Kosovës, Neni 79 i KP të Malit të Zi, Neni 109 i Ligjit Kroat për gjykatat e të miturve.

drejtësisë për të miturit, iu ka rekomanduar Shteteve Anëtare që ndër format e reja të reagimit të përfshijnë mundësinë që edhe të rriturit e rinj nën moshën 21 vjeç t'i nënshtrohen një trajtimi të krahueshëm me atë të të miturve dhe zbatimit të ndërhyrjeve të njëjta me ato që zbatohen ndaj të miturve, nëse gjykata çmon se ata nuk janë aq të pjekur dhe përgjegjës për veprimet e tyre sa të rriturit e tjerë.<sup>21</sup> Edhe në bazë të Kushtetutës shqiptare të rinjtë, ashtu sikurse fëmijët, kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti.<sup>22</sup> Ndërkohë, me ndryshimet më të fundit në KP vihet re se janë hedhur hapa pozitivë drejt njohjes së kësaj kategorie në KP, si p.sh. me rastin e shtimit të qëndrimit në shtëpi si një alternativë e re e dënimit me burgim, e cila mund të zbatohet edhe “për të rinj, nën moshën 21 vjeç”.<sup>23</sup>

### 3.1 Zbatimi i masave edukuese ndaj të miturve që janë përjashtuar nga dënimi

Përsa i përket grupit të parë të personave ndaj të cilëve mund të jepen masa edukuese, vihet re se kjo masë mund të jepet ndaj të miturve autorë të veprave penale vetëm nëse ata janë përjashtuar nga dënimi. Në bazë të nenit 52 të KP gjykata mund ta përjashtojë të miturin nga dënimi nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, si dhe sjellja e mëparshme e të miturit.<sup>24</sup> Si rrjedhim, për të miturit 14-18 vjeç masa edukuese është “sekondare”<sup>25</sup> ndaj dënimit penal, i cili mbetet parësor për këtë grup-moshë. Për këta fëmijë rregulli është caktimi i dënimit penal, ndërsa vetëm si përjashtim dhe në varësi të rrethanave të përmendura në nenin 52 të KP ndaj tyre mund të caktohet masa edukuese e vendosjes në institucion edukimi. Në legjislacionet e disa shteteve të tjera vihet re se për këtë grup-moshë njihen diferencime të mëtejshme si ndarja në të mitur të rinj dhe të mitur të rritur dhe parashikohet shprehimisht se për të miturit e rinj që zakonisht përfshijnë moshën 14-16 vjeç, në shtete në të cilat mosha minimale për përgjegjësi penale është 14 vjeç, mund të jepen vetëm masa edukuese, ndërsa dënimet penale mund të jepen vetëm duke filluar nga grup-mosha e të miturve të rritur ndonëse edhe në këtë rast vetëm për disa vepra penale të rënda, si një përjashtim nga rregulli i zbatimit të masave edukuese.<sup>26</sup>

<sup>21</sup> Committee of Ministers of the Council of Europe, *Recommendation Rec(2003)20 of the Committee of Ministers to member states concerning new ways of dealing with juvenile delinquency and the role of juvenile justice* (Adopted on 24 September 2003), paragrafi III/11, <<http://www.coe.int>>, akses më 10.08.2010.

<sup>22</sup> Në nenin 54 (1) të Kushtetutës parashikohet se edhe të rinjtë ashtu si edhe fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti.

<sup>23</sup> Alternativë e shtuar me nenin 4 të ligjit nr.10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

<sup>24</sup> Mundësia e caktimit të masës edukuese ndaj të miturit që përjashtohet nga dënimi është parashikuar shprehimisht edhe në këtë dispozitë (N.52, paragrafi i dytë).

<sup>25</sup> V.Kambovski, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup 2007, f. 602.

<sup>26</sup> Për shembull në Ligjin penal për të mitur të Kosovës parashikohet se ndaj të miturve, të cilët nuk e kanë mbushur moshën *gjashtëmbëdhjetëvjeçare* në kohën e kryerjes së veprës penale nuk mund të jepen dënime, por vetëm *masat* (Neni 6/3).

### 3.2 Zbatimi i masave edukuese ndaj fëmijëve që nuk kanë arritur moshën për përgjegjësi penale

Një veçori tjetër e masës edukuese të parashikuar në KP shqiptar është se ajo mund të zbatohet edhe ndaj fëmijëve që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale dhe pa asnjë kufi minimal moshe të përcaktuar për dhënien e saj. Në vende të tjera, në të cilat parashikohen masa ndaj personave nën MMPP caktohet edhe mosha minimale për zbatimin e tyre, si p.sh. 8-13 vjeç në KP grek, ku mosha 13 vjeç është MMPP.<sup>27</sup> Në KP shqiptar nuk parashikohet shprehimisht një kufizim i tillë i moshës për zbatimin e masës edukuese ndaj fëmijëve nën MMPP. Në bazë të nenit 12 të KP mosha minimale për përgjegjësi penale (MMPP), e cila ndryshon në varësi të llojit të veprës penale është 14 vjeç për çdo lloj krimi dhe 16 vjeç për kundërvajtjet penale. Nën këto kufij minimal të moshës asnjë individ nuk mund të merret në përgjegjësi penale. Në bazë të Nenit 40/3/a të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, i cili iu kërkon shteteve Palë që të caktojnë një MMPP, fëmijët nën MMPP “*presumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal*”. Si rrjedhim, ndonëse edhe këta fëmijë mund të jenë të aftë për të shkelur ligjin penal, nëse ata kryejnë një vepër penale kur janë nën MMPP, atëherë sipas *presumimit të pakundërshtueshëm* ata nuk mund të akuzohen dhe të mbajnë përgjegjësi sipas një procedure penale.<sup>28</sup>

Sipas Defence for Children International, MMPP është një indikator i rëndësishëm i gjendjes në të cilën ndodhet sistemi i drejtësisë për të miturit në një shtet të caktuar.<sup>29</sup> Aktualisht MMPP varion në vende të ndryshme të botës, duke filluar nga mosha shumë të vogla si 7 vjeç e deri në moshën 18 vjeç.<sup>30</sup> Në Europë vihet re se në shumicën e shteteve të Europës Lindore dhe Qendrore MMPP është më e lartë se ajo që është përcaktuar në shumë vende të Europës Perëndimore.<sup>31</sup> Një karakteristikë tjetër e disa vendeve të

<sup>27</sup> Sipas Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Europianë në KP të Greqisë përcaktohet se fëmijët e moshës 8 deri 13 vjeç që kanë kryer vepra penale ndiqen penalisht, por ndaj tyre Gjykata e të miturve cakton vetëm masa disiplinore ose ndreqëse. (Consultative Council of European Prosecutors (CCPE), *Questionnaire on principles of public prosecution as regards juvenile justice-Greece*, Strasbourg, 4 December 2009, CCPE(2009)10REV3, <[http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccpe/opinions/travaux/OP\\_5\\_Question\\_Grece.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccpe/opinions/travaux/OP_5_Question_Grece.pdf)>, aksesuar më 10.08.2010.

<sup>28</sup> Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 “Children’s rights in juvenile justice”* (CRC/C/GC/10), 2007.

<sup>29</sup> Defence for Children International, “*From legislation to action?-Trends in Juvenile Justice systems across 15 countries*”, Geneva, 2007, f. 25, në <<http://www.defenceforchildren.org/files/DCI-JJ-Report-2007-FINAL-VERSION-with-cover.pdf>>, aksesuar më 10.08.2010.

<sup>30</sup> Po aty, f.22.

<sup>31</sup> A.Othmani, Penal Reform International, *Young offenders and youth at risk: Overview of current international approaches-Juvenile Justice in Europe*, a paper presented at the Conference on “Developing Citizenship amongst youth in conflict with the Law”, 2002, shih: <[http://www.unhabitat.org/downloads/docs/1844\\_23268\\_Juvenile\\_Justice.pdf](http://www.unhabitat.org/downloads/docs/1844_23268_Juvenile_Justice.pdf)>, aksesuar më 10.08.2010.

Europës Lindore, si p.sh. Estoni, Maqedoni, Poloni, dhe Ukrainë është se MMPP mund të ulet në rastin e veprave penale të rënda.<sup>32</sup> Në Shqipëri MMPP parashikohet më e ulët për krimet, si vepra penale më të rënda, pa kufizime të mëtejshme për lloje të caktuara të krimeve pasi të gjitha llojet e krimeve sjellin përgjegjësi penale nëse janë kryer në moshën 14 vjeç.

Vetë Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës nuk e ka përcaktuar MMPP në nenin 40 të saj, por sipas Komitetit për të Drejtat e Fëmijës një MMPP nën moshën 12 vjeç do të konsiderohet se nuk është ndërkombëtarisht e pranueshme dhe në këtë kontekst Shteteve Palë iu rekomandohet që të rrisin kufirin e ulët të MMPP deri në 12 vjeç, si moshë minimale absolute, si dhe të vazhdojnë me një rritje të mëtejshme të tij në nivele edhe më të larta, mundësisht 14 ose 16 vjeç.<sup>33</sup> Në Shqipëri ka patur diskutime në lidhje me ndryshimin e MMPP-së, kryesisht për unifikimin e dy kufijve minimalë duke rekomanduar moshën 16 vjeç si MMPP për çdo lloj veprave penale. Këto diskutime janë zhvilluar edhe në KRL gjatë punës për paketën ligjore për drejtësinë për të miturit duke arritur në konkluzionin se mënyra se si kjo moshë është përcaktuar aktualisht në KP konsiderohet se është në koherencë si me gjendjen aktuale të kriminalitetit të fëmijëve ashtu edhe me faktorë të tjerë që ndikojnë në përcaktimin e MMPP-së.<sup>34</sup>

Në bazë të KP shqiptar kufijtë minimalë të moshës për përgjegjësi penale shërbejnë edhe si një bazë për të dalluar “statusin e ndryshueshëm penalo-juridik”<sup>35</sup> të fëmijëve autorë të veprave penale nën MMPP dhe në MMPP (të miturit), trajtimin e mundshëm të tyre me masa edukuese, përkatësisht sipas rastit me masa edukuese për fëmijët nën MMPP apo me dënime penale dhe vetëm përjashtimisht e sipas rastit me masa edukuese për të miturit që përjashtohen nga dënimi. Vlen të theksohet se përjashtimi nga përgjegjësia penale për fëmijët nën MMPP nuk përjashton mundësinë e marrjes në përgjegjësi penale të të miturve apo madhorëve që i kanë shtyrë apo tërhequr ata për të kryer një krim. Sipas një studimi të CRCA-së shtytja e fëmijëve nën MMPP për të kryer një vepër penale, duke përfutur nga përjashtimi nga përgjegjësia penale për shkak të moshës nën MMPP mbetet një problem madhor në Shqipëri.<sup>36</sup> Në bazë të KP shtytja ose tërheqja e të miturve nën MMPP për të kryer një krim përbën një figurë të veçantë krimi.<sup>37</sup> Ndërkohë, në bazë të Kodit të Familjes nëse bashkëpunëtorë në veprën penale të kryer nga fëmija kanë qenë vetë prindërit e tij, atëherë këta të fundit nëpërmjet vendimit penal të dënimit humbasin

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 “Children’s rights in juvenile justice”*, 2007.

<sup>34</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri*, 2007, f.30.

<sup>35</sup> V.Kambovski, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup 2007, f.605.

<sup>36</sup> Po aty, f.31.

<sup>37</sup> Shih nenin 129 të KP.



edhe përgjegjësinë prindërore dhe fëmija i tyre rrezikon në këtë mënyrë të kalojë në kujdestari.<sup>38</sup>

#### 4. Llojet e masave edukuese

Në KP aktual parashikohet vetëm një lloj mase edukuese dhe konkretisht “vendosja e të miturit në një institucion edukimi”. Kjo masë me karakter institucional, e cila është e vetmja masë edukuese që mund të zbatohet qoftë ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi, qoftë ndaj fëmijëve nën MMPP, konsiston në mbylljen e detyrueshme të fëmijës në një institucion të posaçëm edukimi.<sup>39</sup> Fëmijës që vendoset në mënyrë të detyruar në një institucion edukimi i kufizohen disa të drejta dhe liri, pasi ky institucion i posaçëm imponon një regjim të veçantë jetese dhe marrëdhënie të kontrolluara me familjen.<sup>40</sup>

Në KP të mëparshëm parashikoheshin dy lloje të masave edukuese, të cilave me ndryshimet e vitit 1988 iu shtuan edhe pesë lloje të tjera që mund të zbatoheshin kryesisht ndaj madhorëve.<sup>41</sup> Mbyllja në një institucion edukimi parashikohej edhe në KP të vitit 1928,<sup>42</sup> por në dispozitat përkatëse sqaroheshin edhe disa detaje të nevojshme në lidhje me këtë masë, si p.sh. përcaktime në lidhje me llojet e veprave penale për të cilat mund të jepej kjo masë, rregulla për revokimin, zbatimin e saj etj. Kështu, vlen të theksohet se për fajtorët e vegjël, të cilët në kohën e kryerjes së fajit (veprës penale) nuk kishin mbushur moshën 10 vjeç (ndaj të cilëve për shkak të moshës nuk lejohej ndjekja penale) gjykata, me kërkesën e prokurorit, mund të urdhëronte mbylljen në një institut edukimi dhe përmirësimi, kur ekzistonin të tilla, vetëm nëse fëmija kishte kryer një faj të ndëshkueshëm “me vdekje, me burgim të përjetshëm me burgim të randë ose me burgim jo ma pak se një vit”.<sup>43</sup> Mbyllja në këtë institut edukimi dhe përmirësimi vazhdonte deri sa fajtori të mbushte moshën 20 vjeç, por në çdo kohë gjykata kishte të drejtë të revokonte vendimin e mbylljes në këtë institut ose të urdhëronte që fëmija t’i dorëzohej prindërve ose atij që ligji i ngarkonte kujdesin e edukimit të tij. Në lidhje me rastin e dytë, kur urdhërohej dorëzimi i fëmijës prindërve ose kujdestarit të tij, parashikohej se

<sup>38</sup> Neni 223 i Kodit të Familjes.

<sup>39</sup> Neni 46 i Ligjit Nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

<sup>40</sup> I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2009, f.230; Sh.Muçi, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, 2007, f. 261, 320.

<sup>41</sup> Në nenin 28, paragrafi i tretë i KP të vitit 1977, pas ndryshimeve të vitit 1988 parashikoheshin këto shtatë lloje të masave edukuese: qortimi shoqëror, lënia e personit për edukim kolektivit ose organizatave shoqërore, shtytja e afarit të atestimit për 1 vit, zbritja në detyrë ose caktimi në një punë që paguhet më pak në 6 muaj në të njëjtën ndërmarrje, institucion e organizatë shoqërore ose edhe në një ndërmarrje, institucion a organizatë shoqërore tjetër brenda rrethit, ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie të caktuar, për një kohë nga 1 deri në 5 vjet, largimi nga puna, si dhe vendosja e të miturve në një institucion edukimi.

<sup>42</sup> Tre dispozitatë të këtij KP (nenet 54 -56) mbulonin çështjen e trajtimit të fëmijëve që kryejnë vepra penale, duke dalluar tre kategori kryesore : fëmijët nën 10 vjeç, fëmijët 10-15 vjeç si dhe ata të moshës 15-18 vjeç.

<sup>43</sup> Neni 54 (2) i Kodit Penal të vitit 1928.

gjykata i jepte atyre *porosi* që “të kujdesen për rrejtjen dhe edukimin dhe të vërejnë sjelljet e tija, se, në rast që këta nuk e vërejnë dhe kështu i vogëli ban ndonjë delikt të çdo lloji, kanë me pague një gjobë të lehtë nga një qint deri në pesqint fr.ari të cilën e cakton n’at vendim.” Pra, prindërit ose kujdestari paralajmëroheshin mbi pagesën e një *gjobe* të lehtë, të përcaktuar në vendim, në rast se fëmija kryente një *delikt* të çdo lloji ndërkohë që ata nuk kishin përbushur detyrimet e tyre në “*vërejtjen e sjelljeve të tija*”.

Rregullat e parashikuara për fëmijët e moshës nën 10 vjeç, mbi mbylljen në institut edukimi dhe përmirësimi, lirim në moshën 20 vjeç ose revokimin e vendimit apo dorëzimin prindërve apo kujdestarit në çdo kohë me vendim të gjykatës, zbatoheshin edhe për fëmijët e moshës 10-15 vjeç nëse provohej se nuk kishin patur një “*fuqi mëndore çmuëse (discernement)*”<sup>44</sup> dhe nëse kishin kryer të njëjtat vepra penale të rënda të përcaktuara për fëmijët nën moshën 10 vjeç. Ndërkohë, për fëmijët 10-15 vjeç me fuqi mendore çmuëse në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe për fëmijët e moshës 15-18 vjeç përcaktoheshin rregulla të posaçme për zbritjen e ndëshkimit. Për fëmijët e moshës 15-18 vjeç, të cilët në kohën e dënimit nuk kishin mbushur moshën 18 vjeç, parashikohej edhe mundësia që, me urdhër të gjykatës, dënimin kundër lirisë personale ta vuanin në një institut përmirësimi.

#### 4.1 Masat ndaj fëmijëve nën MMPP

Përsa i përket çështjes nëse është e nevojshme që në reformën në sistemin e drejtësisë për të miturit të trajtohet edhe situata e fëmijëve që me sjelljen e tyre shkelin ligjin penal, por që për shkak të *moshës nën kufirin minimal të përcaktuar në ligj* nuk mund të ndiqen penalisht, sipas UNICEF-it standartet ndërkombëtare mbi drejtësinë për të miturit janë paksa të paqarta.<sup>45</sup> Kështu, në lidhje me termin fëmijë “i dyshuar” për kryerjen e një shkelje të ligjit penal, term i cili është përdorur në nenin 40 të Konventës për të drejtat e fëmijës duke iu referuar fëmijëve ndaj të cilëve kjo dispozitë është e zbatueshme, nuk është plotësisht e qartë nëse ky term përfshin apo jo edhe fëmijët që kanë kryer një vepër penale, por që janë nën MMPP.<sup>46</sup> Rregullat e Pekinit mbi administrimin e drejtësisë për të miturit në parim janë të zbatueshme për çdo fëmijë që ka kryer një vepër penale, pra jo vetëm për fëmijët që kanë mbushur MMPP. Megjithatë, Komenti i përgjithshëm mbi të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të miturit, i miratuar nga Komiteti për të drejtat e fëmijës në Shkurt 2007 thotë shumë pak përse i përket mënyrës se si duhen trajtuar fëmijët nën MMPP kur ata kryejnë një vepër penale.<sup>47</sup> Në paragrafin 31, Komiteti gjatë komentimit të nenit 40(3) të KDF-së mbi detyrimin e shteteve palë për të përcaktuar një

<sup>44</sup> Neni 55 i Kodit Penal të vitit 1928.

<sup>45</sup> UNICEF, Regional Office for CEE/CIS DRN, *Evaluation of UNICEF’s contribution to Juvenile Justice System Reform*, Final Evaluation Report, March 2007, f. 34, shih: <[http://www.unicef.org/ceecis/JJ-EVA\\_EvaluationReport\\_DRN283-final\\_version.pdf](http://www.unicef.org/ceecis/JJ-EVA_EvaluationReport_DRN283-final_version.pdf)> aksesuar më 10.08.2010.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> Po aty, f. 35.

moshe minimale për përgjegjësi penale shprehet se fëmijët nën MMPP që kanë kryer një veprë penale nuk mund të procedohen penalisht, por ndaj tyre mund të merren *masa të veçanta mbrojtëse* nëse është e nevojshme në interesin e tyre më të lartë.<sup>48</sup> UNICEF ka vlerësuar që në mbështetje të reformës në sistemin e drejtësisë për të miturit do të ishte e përshtatshme që të përfshihen së paku disa veprimtari në dobi të fëmijëve nën MMPP, veçanërisht ato që synojnë parandalimin e kriminalitetit dhe shërbime për “rehabilitimin” e fëmijëve të përfshirë në veprimtari të ndaluara, në veçanti shërbime me bazë në komunitet si këshillime ose ndërmjetësime që nuk sjellin kufizim të lirisë.<sup>49</sup>

Nevoja për trajtim të fëmijëve nën MMPP ka dalë në pah edhe për shkak të tendencës në rritje të përfshirjes së tyre në sjellje kriminale në mosha gjithmonë e më të reja. Vitet e fundit kriminaliteti i fëmijëve është kthyer në një çështje gjithmonë e më shqetësuese dhe nën këqyrje të kujdesshme në nivel Europian, gjë që ka detyruar edhe institucionet Europiane që në përgjigje të shqetësimit publik në vitet 2006 dhe 2007 të fillojnë të eksplorojnë mundësitë për një strategji mbarë-europiane.<sup>50</sup> Këshilli i Europës e ka vendosur parandalimin e kriminalitetit të të miturve dhe drejtësinë për të miturit si një prioritet të tij për bashkëpunim në fushën e parandalimit të kriminalitetit dhe politikës kriminale; po kështu, Parlamenti Europian në Qershor 2007 ka miratuar një rezolutë mbi kriminalitetin e të miturve, rolin e grave, familjes dhe shoqërisë, në të cilën theksohet se kriminaliteti i të miturve po bëhet një çështje shqetësuese përsa i përket shtrirjes së gjerë që ka marrë tani për shkak se kriminaliteti po fillon të shfaqet në mosha akoma më të reja, numri i veprave penale të kryera nga fëmijët nën moshën 13 vjeç po shtohet, si dhe veprat e kryera nga të miturit po bëhen gjithnjë e më tepër brutale.<sup>51</sup>

Edhe në Shqipëri sipas një studimi të CRCA-së dhe UNICEF-Shqipëri mbi Drejtësinë për të miturit në Shqipëri, vihet re se një nga tendencat kryesore të zhvillimit të kriminalitetit fëmijëror është edhe rritja e konsiderueshme e numrit të fëmijëve nën moshën 14 vjeç si autorë të veprave penale, e cila në disa raste ka arritur edhe në 10 deri 20 përqind nga një vit në tjetrin.<sup>52</sup> Përsa i përket llojit të veprave penale, fëmijët janë përfshirë më së shumti

<sup>48</sup> Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 “Children’s rights in juvenile justice”* (CRC/C/GC/10), 2007, paragrafi 31.

<sup>49</sup> UNICEF ka mbështetur projekte pilot, të cilat iu janë drejtuar në mënyrë specifike dhe ekskluzive këtij grupi të fëmijëve, si p.sh. në Rumani. Për më shumë shih: UNICEF, Regional Office for CEE/CIS, *Evaluation of UNICEF’s contribution to Juvenile Justice System Reform*, Final Evaluation Report, March 2007, f. 35.

<sup>50</sup> Defence for Children International, *“From legislation to action?-Trends in Juvenile Justice systems across 15 countries”*, Geneva, 2007, f. 27.

<sup>51</sup> Po aty.

<sup>52</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri-Një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri*, Tiranë, 2007, f. 80-81.

në krimet kundër pasurisë, kryesisht vjedhje të pasurisë, si dhe vjedhje në bashkëpunim dhe më shumë së një herë,<sup>53</sup> dhe pas tyre vijnë krimet kundër personit.<sup>54</sup>

Vlen të theksohet se në përgjithësi në shtete të tjera në të cilat masat edukuese janë sanksione penale që zbatohen ndaj të miturve, ndaj fëmijëve nën MMPP mund të merren vetëm masa të tjera jopenale juridike të edukimit, kujdesit dhe mbikqyrjes nga ana e shërbimeve sociale edhe nëse ata kanë kryer krime të rënda.<sup>55</sup> Kështu, për shembull, duke iu referuar praktikës së katër shteteve të ndryshme në Europë, të cilat kanë kufij të ndryshëm të MMPP në krahasim me atë të parashikuar në KP shqiptar duke filluar nga kufiri më i ulët 10 vjeç e deri në atë më të lartin 18 vjeç vihet re se fëmijët nën këtë moshë iu nënshtrohen kryesisht masave të tjera, të cilat nuk bazohen në ligjin penal:

- 1) Në Hollandë “STOP-reaction” bën të mundur reagimin ndaj veprave penale të kryera nga fëmijë nën moshën 12 vjeç, i cili nuk bazohet në ligjin penal, por atë civil dhe fokusi pjesërisht është tek prindërit, pjesëmarrja është vullnetare si dhe përfshin konferenca ose detyra për të mësuar.<sup>56</sup>
- 2) Në Belgjikë ku MMPP është 18 vjeç, fëmijët nën këtë moshë ndonëse konsiderohen se nuk janë penalisht përgjegjës përsëri mund të trajtohen me masa edukative ose ata mbi moshën 12 vjeç mund të vendosen në një institucion publik për mbrojtjen e të rinjve.<sup>57</sup>
- 3) Në Kroaci në bazë të ligjit specifik për Gjykatat e të miturve, kur gjatë procedimit verifikohet se në kohën e kryerjes së veprës penale, personi ka qenë nën 14 vjeç (fëmijë), procedimi penal do të pushojë dhe informacioni rreth veprës penale dhe autorit të saj do t’i paraqiten qendrës së kujdesit social, e cila ndërmer masa ligjore të mbrojtjes familjare përsa i përket fëmijës dhe nëse është e nevojshme edhe për familjen e tij.<sup>58</sup>
- 4) Në Angli për të miturit nën MMPP gjykata mund të lëshojë urdhër për mbrojtjen e fëmijës, në bazë të të cilit fëmija nën moshën 10 vjeç autor i një veprë penale, për

<sup>53</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri- Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri*, Tiranë, Qershor 2007, f. 16-20.

<sup>54</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri*, 2007, f. 30.

<sup>55</sup> V.Kambovski, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, 2007, f.604-607.

<sup>56</sup> Defence for Children International, “From legislation to action?-Trends in Juvenile Justice systems across 15 countries”, Geneva, 2007, f. 25.

<sup>57</sup> Po aty, f. 36.

<sup>58</sup> Neni 44 i ligjit për gjykatat e të miturve, shih: <[http://www.vsrh.hr/CustomPages/Static/HRV/Files/Legislation\\_\\_Juvenile-Courts-Act.pdf](http://www.vsrh.hr/CustomPages/Static/HRV/Files/Legislation__Juvenile-Courts-Act.pdf)>, aksesuar më 20.07.2010, si dhe B.Cvjetko, *Criminal responsibility of minors in the Republic of Croatia*, International Review of Penal Law (Vol. 75), f. 265.

të cilën nëse do të kishte arritur këtë moshë do të kishte përgjegjësi penale, vendoset nën mbikqyrjen e punonjësit social ose të drejtësisë për të rinjtë dhe fëmijës i kërkohet të përmbushë disa kërkesa specifike të përcaktuara nga gjykata.<sup>59</sup>

Ndërkohë në Shqipëri, një nga problemet aktuale me të cilat ballafaqohet sistemi i drejtësisë për të miturit që është theksuar në disa raporte apo vlerësime të organizmave ose institucioneve të ndryshme është pikërisht mungesa e mekanizmave të reagimit dhe referimit për fëmijët nën MMPP që janë në konflikt me ligjin (veçanërisht ata nën 14 vjeç që kryejnë krime të rënda). Kështu, në Raport Progresin e vitit 2009 të Komisionit të BE-së theksohet se “sistemit të drejtësisë për të miturit i mungojnë mekanizmat e reagimit dhe referimit për fëmijët nën 14 vjeç që kryejnë krime.” Po kështu edhe CRCA/ DCI Albania në dokumentin informativ “*Situata e të miturve në konflikt me ligjin*”(2009) konstaton se “trajtimi i duhur i fëmijëve që kryejnë krime nën MMPP është shumë i vështirë.”<sup>60</sup>

#### 4.2.Masat edukuese ndaj të miturve

Përsa i përket masave edukuese, të cilat mund të zbatohen ndaj fëmijëve që kanë mbushur MMPP, në legjislacionet penale të shteteve të tjera vihet re një larmishmëri më e madhe e llojeve të tyre. Në shumë shtete të rajonit si p.sh. Slloveni, Kosovë, Mal i Zi, Kroaci, në përgjithësi, masat edukuese, të cilat janë parësore në raport me dënimin me burgim për të miturit grupohen në disa kategori kryesore të renditura nga më e lehta deri tek më e rënda. Kryesisht njihen tre kategori kryesore, të cilat konsistojnë në masa disiplinore, masa të mbikqyrjes së shtuar, si dhe masa institucionale. Për secilin prej llojeve të masave edukuese janë përcaktuar në ligj kushtet dhe kriteret për dhënien e tyre në raste konkrete. Përsa i përket masave edukuese institucionale, ato konsiderohen masat më të rënda dhe kërkohet që të caktohen vetëm në rastet kur gjykata çmon se qëllimi i masave edukuese nuk mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të masave të tjera më të lehta. Gjithashtu, edhe tek masat institucionale vihet re se në këto legjislacione të huaja penale njihen disa lloje të ndryshme të tyre.<sup>61</sup>

<sup>59</sup> M.Cavadino, J.Dignan, *The penal system, an introduction*, Third edition, SAGE publications, 2003, f.302.

<sup>60</sup> Për këtë problem është diskutuar edhe në Takimin me temë “Mbrojtja e fëmijëve, detyrim kushtetues dhe ligjor”, të organizuar nga Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit, Tiranë, 25 Tetor 2006, ku ndër të tjera konstatohet se “Mungesa e institucioneve për fëmijët nën 14 vjeç që janë në konflikt me ligjin ka sjellë probleme për Policinë e Shtetit pasi janë identifikuar shumë fëmijë të kësaj grup moshe me një numër të madh precedentësh penal të cilët lihen në gjendje të lirë.” Shih: <<http://www.avokatipopullit.gov.al/Aktivitetet/Akt%2025102006.htm>>, aksesuar më 10.08.2010.

<sup>61</sup> Për shembull në Ligjin penal për të mitur të Kosovës (në ngjashmëri me përcaktimet në KP apo ligje të posaçme të shteteve të tjera të rajonit si Slloveni, Mal i Zi, Maqedoni, Kroaci) parashikohen tre lloje të masave institucionale: dërgimi i të miturit në institucion edukues, dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues, si dhe dërgimi i të miturit në institucionin e kujdesit të posaçëm [mjekësor]. (Ligji

Duke patur parasysh rëndësinë që ka parashikimi në ligj i llojeve të ndryshme të masave edukuese në mënyrë që fëmijëve të mund “t’ju sigurohet një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit”, në nenin 40/4 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës përcaktohet shprehimisht detyrimi i shteteve Palë për të parashikuar “dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale”. Në komentin përkatës të Komitetit të të Drejtave të Fëmijës theksohet se është e nevojshme që - si pjesë e një politike gjithëpërfshirëse mbi drejtësinë për të miturit – të miratohet dhe të zbatohet “një seri e gjerë masash” që të sigurohet se fëmijët trajtohen në një mënyrë që i përshtatet mirëqënies së tyre dhe është në proporcion si me rrethanat e tyre personale ashtu edhe me shkeljen e kryer.<sup>62</sup> Pra, ligjet duhet t’i sigurojnë gjykatës një seri të gjerë alternativash të mundshme ndaj kujdesit institucional, të cilat janë përmendur në formën e një liste të hapur edhe në dispozitën e lartpërmendur të Konventës.<sup>63</sup>

Gjithashtu, në nenin 40/3(b) të Konventës theksohet edhe rëndësia e trajtimit të fëmijëve, “sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, ...pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore”.<sup>64</sup> Në lidhje me mundësinë e përdorimit të shmangies apo moskryerjes së procedurave gjyqësore për të miturit autorë të veprave penale, në Shqipëri në bazë të ligjit “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve”<sup>65</sup> lejohet zgjidhja e *kundërvajtjeve penale* pa iu drejtuar procedurës gjyqësore përmes ndërmjetësimit. Vlen të theksohet se në Shqipëri një hap tepër pozitiv në lidhje me trajtimin e të miturve autorë të veprave penale është ndërmarrë nga qeveria shqiptare në vitin 2008 përmes projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në

---

penal për të mitur i Kosovës, neni 17(4), shih: <<http://www.kosovopoliice.com/repository/docs/LigjperMitur.pdf>>, aksesuar më 12.08.2010.

<sup>62</sup> Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 “Children’s rights in juvenile justice”* (CRC/C/GC/10), 2007.

<sup>63</sup> Po aty.

<sup>64</sup> Në Komentarin zyrtar të “Rregullave të Pekinit” (Rregullat Standarte Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit) theksohet se: “Shmangia, përfshirë këtu dhe moskryerjen e procedurave gjyqësore së bashku me shërbimet mbështetëse të komunitetit, është praktikuar në një bazë formale dhe joformale në shumë sisteme ligjore. Kjo praktikë shërben për të mënjeluar efektet negative të procedurave gjyqësore në çështjet e të miturve (psh. etiketimin si delinkuent i të miturve dhe dënimet e tyre). Në shumë raste, mosndërrhyrja do të ishte përgjigjia më e mirë. Kështu, shmangia nga procedurat normale dhe aplikimi i shërbimeve alternative (sociale) do të jetë diçka optimale. Ky është rasti kur shkelja nuk është serioze dhe kur familja, shkolla ose institucionet e tjera të kontrollit social kanë reaguar ose do të reagojnë në mënyrën e duhur dhe të dobishme.” (Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara me mbështetjen e Save the Children Albania, *Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës- Studim Krahasues*, 2007, f. 392, <<http://www.scalbania.org/1.pdf>>, akses më 10.08.2010.)

<sup>65</sup> Ligji nr. 8465, datë 11.03.1999 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve”.

KP. Këto ndryshime dhe shtesa në KP kanë sjellë disa risi në lidhje me dënimet alternative të zbatueshme edhe ndaj të miturve që kanë kryer një veprë penale, si p.sh. është shtuar qëndrimi në shtëpi, gjysëmliria etj. Gjithashtu, në disa nga dispozitat e ndryshuara ose të shtuara në kapitullin përkatës vihet re se rrethana e moshës së autorit të veprës penale është shtuar shprehimisht si një ndër faktorët që do të merret parasysh gjatë caktimit të dënimeve alternative ndaj dënimit me burgim. Sipas një studimi të Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara disa nga këto dënime alternative shërbejnë edhe si “masa edukuese ose riintegruese”<sup>66</sup> për të miturit si p.sh. pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim etj.

Vlen të theksohet se këto alternativa, në vetvete mbeten dënime që në rast të shkeljes së kushteve dhe detyrimeve përkatëse mund të zëvendësohen edhe me dënimin me burgim dhe si të tilla ato nuk mund të plotësojnë hendekun e krijuar nga mungesa e llojeve të ndryshme të masave edukuese që mund të zbatohen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi. Megjithatë, kjo reformë si një ndër më të rëndësishmet në sistemin penitenciar dhe të drejtësisë penale, e cila është bazuar në praktikën më të mira të legjislacioneve penale të vendeve të tjera dhe rekomandimet e Këshillit të Europës,<sup>67</sup> shërben si një pikënisje e mirë për zhvillime të mëtejshme edhe në lidhje me trajtimin e veçantë të të miturve në konflikt me ligjin, përmes masave edukuese. Në ngjashmëri me situatën aktuale në lidhje me masat edukuese (një masë e pazbatueshme në praktikë), para ndryshimeve të vitit 2008 shumë dispozita mbi dënimet alternative përdorshin ose shumë rrallë ose aspak nga gjykata. Ndryshimet dhe shtesat në ligj erdhën pikërisht në funksion të realizimit të prioritetit të qeverisë mbi përfundimin e bazës ligjore për funksionimin efektiv të këtij instituti të rëndësishëm të së drejtës penale.<sup>68</sup>

Në lidhje me shtesat e mundshme në llojet e masave edukuese, të zbatueshme ndaj të miturve autorë të veprave penale vlen të theksohet se synimi kryesor në përcaktimin e llojeve të masave edukuese duhet të reflektojë qëllimin pozitiv rehabilitues që duhet të ketë një sistem i drejtësisë për të mitur, sikurse përcaktohet edhe në nenin 40(1) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, sipas të cilit shtetet Palë duhet “t’i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë që:

- zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit;
- përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve; dhe

<sup>66</sup> Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara me mbështetjen e Save the Children Albania, *Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës- Studim Krahasues*, 2007, f.395-396.

<sup>67</sup> Relacioni për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, <<http://www.justice.gov.al>> akses më 19.12.2008.

<sup>68</sup>Po aty, f.10.

- merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në ri-integrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj”.<sup>69</sup>

## 5. Zbatimi i masës edukuese në Shqipëri

### 5.1.Kriteret për zbatimin e masës edukuese

Në nenin 46 të Kodit Penal parashikohet shprehimisht vetëm një kusht apo kriter i zbatimit të masave edukuese, sipas të cilit këto lloj masash mund të zbatohen vetëm ndaj fëmijëve apo të miturve që kanë kryer një veprë penale. Në lidhje me kriteret e tjera në bazë të të cilave gjykata jep masën edukuese, në dallim nga legjislacione të tjera të huaja, në KP shqiptar nuk janë përcaktuar shprehimisht në nenin 46 duke i lënë kështu në vlerësimin e gjykatës që rast pas rasti në bazë të rrethanave konkrete të çmojë me vendim të arsyetuar nëse është e nevojshme apo jo marrja e një mase të tillë.<sup>70</sup> Sipas teorisë së të drejtës penale, në çdo rast vendosja e të miturve në një institucion edukimi bëhet nëpërmjet një vendimi të arsyetuar dhe të mbështetur në *tërësinë e rrethanave në të cilat është kryer vepra penale* nga ana e të miturit.<sup>71</sup>

Në lidhje me grupin e të miturve që përjashtohen nga dënimi, në KP janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme rrethanat në bazë të të cilave i mituri mund të përjashtohet nga dënimi,<sup>72</sup> por një përcaktim i tillë mungon në lidhje me mundësinë e vendosjes së të miturit në një institucion edukimi. Po kështu edhe përsa i përket grupit të dytë, të fëmijëve nën MMPP, KP nuk përmban ndonjë përcaktim konkret të kriterëve për caktimin e masës edukuese.<sup>73</sup> Në teorinë e së drejtës penale është shprehur mendimi se, në përgjithësi, masa edukuese jepet në ato raste kur i mituri ka kryer veprime ose mosveprime që parashikohen si veprë penale dhe karakteri i veprës, sjelljet e mëparshme të tij dhe familja apo mjedisi që ndikon mbi të nuk garantojnë moskryerjen e veprave të tjera të rrezikshme dhe edukimin normal të këtij të mituri.<sup>74</sup> Në këtë kontekst, në qendër

<sup>69</sup> Edhe në Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të KE-së mbi mënyrat e reja të trajtimit të kriminalitetit të të miturve dhe rolin e drejtësisë për të miturit (*Rec(2003)20*), paragrafi II/1 theksohet se qëllimet apo synimet kryesore të drejtësisë për të miturit dhe të masave përkatëse për ndalimin e kriminalitetit të të miturve duhet të jenë si më poshtë vijon:

- të parandalohet kryerja e veprave penale dhe recidivizmi,
- të (ri)socializohen dhe (ri)integrohen autorët e veprave penale, si dhe
- të adresohen nevojat dhe interesat e viktimave.

<sup>70</sup> Marrja parasysh e rrethanave përmendet në nenin 46 KP vetëm në mënyrë indirekte dhe të përgjithshme, në kontekstin e revokimit të vendimit gjyqësor për masën edukuese: “Vendimi gjyqësor për masat edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken *rrethanat për të cilat ai është dhënë...*”.

<sup>71</sup> I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2009, f. 231.

<sup>72</sup> Në nenin 52 të KP.

<sup>73</sup> Neni 46 i KP.

<sup>74</sup> Sh.Muçi, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, 2007, f. 262.



të vëmendjes së gjykatës kur cakton një masë edukuese në çdo rast duhet të jetë *interesi ose mirëqenia e fëmijës*.

Në bazë të Rregullave të Pekinit dy objektivat apo synimet kryesore të drejtësisë për të miturit janë promovimi i mirëqënies së të miturit, si dhe *parimi i proporcionalitetit*. Ky i fundit nënkupton se reagimi ndaj të miturve autorë të veprave penale duhet të jetë *në proporcion me rrethanat e autorit si dhe të veprës*, pra duhet të bazohet në marrjen në konsideratë jo vetëm të *peshës së veprës*, por edhe të *rrethanave personale*.<sup>75</sup> Ndër rrethanat personale të autorit të veprës, të cilat duhet të ndikojnë në proporcionalitetin e reagimeve përmenden statusi social, situata familjare, dëmi i shkaktuar nga vepra ose faktorë të tjerë që ndikojnë në rrethanat personale.<sup>76</sup> Po kështu edhe Komiteti për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm Nr.10 (2007) ka theksuar se “reagimi ndaj një vepre penale duhet të jetë gjithmonë në proporcion jo vetëm me rrethanat dhe peshën e veprës, por edhe me moshën, rrethanat dhe nevojat e fëmijës, si dhe me nevojat e ndryshme, veçanërisht ato afat-gjatë, të shoqërisë.”<sup>77</sup>

Ndërkohë, përsa i përket përparësisë së ndonjë rrethane në raport me të tjerat, veçanërisht në rastin e veprave penale të rënda, në të cilat proporcionaliteti mund të merret parasysh duke përfshirë edhe konsideratat mbi nevojën për siguri publike, sipas Komitetit në rastin e fëmijëve *nevoja për të ruajtur mirëqenien dhe interesin më të lartë të fëmijës si dhe për të promovuar ri-integrimin e tij/saj* duhet gjithmonë të kenë *peshë më të rëndësishme* se këto konsiderata. Në këtë kontekst, duke u bazuar edhe në një dispozitë parimore të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (neni 3/1) *interesi më i lartë i fëmijës* duhet të jetë “*konsiderata mbizotëruese*” edhe në vendimin që gjykata do të japë mbi caktimin e masës edukuese ndaj fëmijës autor i veprës penale. Aktualisht parimi i interesit më të lartë të fëmijës si një koncept udhëheqës i trajtimit të fëmijëve nga ligji penal nuk ka gjetur pasqyrim në KP shqiptar,<sup>78</sup> në dallim nga legjislatore të huaja për të miturit në të cilat ai parashikohet shprehimisht.<sup>79</sup> Ndërkohë, vihet re se një hap pozitiv drejt njohjes së këtij parimi në procedurat që lidhen me të miturit është ndërmarrë me miratimin e një akti

<sup>75</sup> Rregullat Standarte Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 40/33, 29 Nëntor 1985, Rregulli 5 dhe Komenti përkatës, <<http://www2.ohchr.org/english/law/beijingrules.htm>>, aksesuar më 10.08.2010.

<sup>76</sup> Po aty, Komenti mbi Rregullin 5.

<sup>77</sup> Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 “Children’s rights in juvenile justice”* (CRC/C/GC/10), 2007, paragrafi 71.

<sup>78</sup> Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, *Legjislatore shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës- Studim Krahasues*, 2007, f. 57.

<sup>79</sup> Për shembull në Ligjin penal për të mitur të Kosovës parashikohet shprehimisht se “kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë ..., gjykata në radhë të parë merr parasysh *interesi më të mirë të të miturit*.” (neni 7/1).

nënligjor në vitin 2009 dhe konkretisht me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës.<sup>80</sup>

## 5.2. Ekzekutimi i masës edukuese: institucionet e posaçme të edukimit

Rregullat për vënien në ekzekutim të masave edukuese përcaktohen në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”,<sup>81</sup> në të cilin parashikohet se “masa edukuese ekzekutohet në institucionet e posaçme të edukimit të të miturve dërguar në mënyrë vullnetare nga prindi ose kujdestari mbi urdhrin e ekzekutimit të prokurorit. Kur nuk bëhet ekzekutim vullnetar në datën e caktuar ose kur nuk ka prindër apo kujdestar, ekzekutimi bëhet nga Policia e Shtetit.” Nga përmbajtja e kësaj dispozite del se ligjvënësi i ka dhënë mundësinë prindit ose kujdestarit të fëmijës që mbi urdhërin e ekzekutimit të prokurorit ta ekzekutojë vetë këtë masë, në mënyrë vullnetare, dhe vetëm nëse ata nuk e shfrytëzojnë këtë mundësi që i ka dhënë ligji ekzekutimi i masës do të bëhet nga Policia e Shtetit. Vetëm nëse i mituri nuk ka prindër ose kujdestarë, masa edukuese ekzekutohet direkt nga policia. Këto rregulla në thelb synojnë që vënia në ekzekutim e masës edukuese të jetë sa më pak “traumatike” për fëmijën, duke mos e ekspozuar fëmijën që në fillim me ekzekutimin e detyruar nga policia, por duke parashikuar mundësinë e shoqërimit të tij për në institucionin e posaçëm të edukimit nga një individ me të cilin ai ka afërsi dhe familjaritet sikurse është figura e prindit ose kujdestarit të tij kur e ka një të tillë.

Sikurse theksohet edhe në ligjin e lartpërmendur masa edukuese e parashikuar në KP ekzekutohet në “institucionet e posaçme të edukimit të të miturve”. Deri në vitin 1988 në Shqipëri ka funksionuar një shkollë edukimi dhe një shkollë riedukimi deri në vitin 1992,<sup>82</sup> të cilat janë mbyllur në vitet 1993-1994.<sup>83</sup> Aktualisht mungon institucioni i posaçëm, në të cilin do të mund të zbatohet masa edukuese e parashikuar në KP. Kjo pamundësi e zbatimit të masave edukuese të parashikuara në KP për shkak të mungesës së institucioneve çmohet se e bën sistemin vetëm “në letër”, nuk garanton të drejtat e të miturve në procesin penal, bëhet shkak për një karakter më tepër ndëshkimor se sa edukues dhe rehabilitues të sistemit të administrimit të drejtësisë për të miturit,<sup>84</sup> si dhe

<sup>80</sup> Në këtë Rregullore parashikohet se në rastet kur i dënuari me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik është person *i mitur*, Shërbimi i Provës në hartimin dhe zhvillimin e programit ditor “duhet të marrë parasysh moshën, *interesin më të lartë të fëmijës*, nevojat psiko-sociale, duke u konsultuar me prindërit, kujdestarin, mbrojtësin e tij ose persona të tjerë të kërkuar nga i mituri.” (Neni 49/2 i Rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, miratuar me VKM nr.302, datë 25.3.2009)

<sup>81</sup> Ligji Nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, Neni 46.

<sup>82</sup> V.Hysi, *Penologjia*, PEGI, Tiranë, 2006, f.169.

<sup>83</sup> Assessment of Juvenile Justice Reform Achievements in Albania, UNICEF, July 2009, f. 20.

<sup>84</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri*, 2007, f. 60, 83.

ndikon në orientimin e politikës kriminale drejt zbatimit të masave represive edhe atëherë kur ekzistojnë rrethana për të zbatuar lloje të tjera trajtimi.<sup>85</sup> Me vendosjen e të miturit në një institucion të posaçëm edukimi kur kjo çmohet e domosdoshme zbatohet edhe standarti i marrjes në konsideratë të parimit të “interetit më të lartë të fëmijës”, pasi nëpërmjet kësaj mase kërkohet të arrihet qëllimi i edukimit të të miturit duke parandaluar në këtë mënyrë sjelljet e tij kriminale në të ardhmen. Ndërkohë që, nëse kjo masë nuk zbatohet, atëherë fëmija nuk do të edukohet, por përkundrazi ekziston rreziku i përfshirjes së tij në sjellje të tjera kriminale, ndoshta edhe më të rënda se vepra e parë për të cilën kërkohet të vihet masa edukuese, pasi sipas studimeve “të miturit e përfshirë në sjellje penale kanë shumë mundësi të vazhdojnë përfshirjen e tyre në vepra penale”.<sup>86</sup> Gjithashtu, trajtimi në kohë të fëmijëve që janë në konflikt me ligjin (kur është e domosdoshme edhe me masa edukuese) është i rëndësishëm edhe për shmangien e kostove të tepërta për shoqërinë, pasi sa më shumë kohë të kalojë aq edhe më “të kushtueshëm” do të jenë këta fëmijë për shoqërinë (do të kenë nevojë për shumë shërbime të tjera të veçanta).<sup>87</sup>

Në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët ndër objektivat specifike në lidhje me reformën juridike dhe masat në ndihmë të fëmijëve janë përfshirë edhe miratimi i paketës ligjore “Mbi drejtësinë për të miturit”, si dhe ngritja e funksionimi i strukturave përkatëse në zbatim të paketës ligjore, ku përmendet edhe Instituti i Riedukimit për të Miturit, si institucion kryesor për ekzekutimin e dënimeve alternative *dhe masave të tjera edukuese*. Qendra e parë e ri-integrimit për të miturit në Shqipëri është hapur në 1 Korrik 2010, në Kavajë dhe nëpërmjet saj synohet të zbatohet në praktikë koncepti i drejtësisë restauruese dhe i ri-integrimit që i kundërvihen masave rreptësisht ndëshkuese ndaj të miturve në konflikt me ligjin penal.<sup>88</sup> Përveç ambjenteve të ndalimit, Qendra ka infrastrukturën e nevojshme për të punuar për ri-integrimin e të miturve në shoqëri. Ngritja e qendrave korrektuese (riintegruese) në Shqipëri theksohej si një nga prioritetet e punës së Ministrisë së Drejtësisë edhe në Raportin fillestar kombëtar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës, të paraqitur nga Shqipëria në KDF, gjatë sesionit të 38-të. Në bazë të raportit të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe UNICEF-it këto qendra do të shërbejnë kryesisht si një fazë e ndërmjetme përgatitore për të miturit që pritet të lirohen nga burgu, me synimin për t’i përgatitur ata në përballjen me realitetin jashtë burgut, por njëkohësisht ato mund dhe duhet të shërbejnë *edhe për të mitur të tjerë* si ata që nuk kanë familje ose nuk mirëprehen në familjet e tyre apo që rrezikojnë të futen në konflikt me palën e dëmtuar.

<sup>85</sup> I.Elezi, V.Hysi, *Politika Kriminale*, PEGI, 2006, f.33-34.

<sup>86</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri*, 2007, f. 16, 40, 57.

<sup>87</sup> Po aty, f.57-58.

<sup>88</sup> Delegation of the European Union to Albania, Press Release, 01.07.2010, <[http://ec.europa.eu/delegations/albania/press\\_corner/all\\_neës/neës/2010/20100701\\_01\\_en.htm](http://ec.europa.eu/delegations/albania/press_corner/all_neës/neës/2010/20100701_01_en.htm)>, akses më 10.08.2010.

### 5.3 Mbikqyrja e zbatimit të masës edukuese: rishqyrtimi dhe revokimi i vendimit gjyqësor përkatës

Sikurse është përmendur edhe më lart tek karakteristikat e masave edukuese, këto të fundit janë masa që jepen pa afat nga gjykata. Megjithatë, në funksion edhe të qëllimit kryesor të kësaj mase, në nenin 46 të KP është parashikuar shprehimisht detyrimi i gjykatës për të marrë në shqyrtim vendimin e saj për masën edukuese pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së tij, si dhe mundësia e revokimit në çdo kohë të këtij vendimi kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë. Revokimi mund të bëhet kryesisht nga gjykata gjatë rishqyrtimit të detyruar të vendimit të saj pas një viti nga dhënia e tij ose para këtij afati me kërkesën e të interesuarit ose të institucionit të edukimit. Në këtë mënyrë gjykata nuk duhet të mjaftohet vetëm me dhënien e masës edukuese ndaj një fëmije, por duhet edhe të ndjekë rregullisht çdo vit ecurinë e zbatimit të saj. Një proces i tillë i ndërlikuar, i cili fillon me caktimin e masës edukuese dhe vazhdon më tej me ndjekjen e zbatimit të masës shtron nevojën për specializimin e organeve që janë pjesëmarrës në procedurë.<sup>89</sup> Aktualisht në Shqipëri janë krijuar seksione të veçanta për të miturit në shtatë gjykata të rretheve gjyqësore<sup>90</sup> dhe në gjashtë prokurori të rretheve gjyqësore.<sup>91</sup> Krijimi i seksioneve për të miturit përbën një hap të rëndësishëm në trajtimin e veçantë, të posaçëm të të miturve që përballen me drejtësinë penale, për të siguruar një gjykim sa më të përshtatshëm për ta.

Në lidhje me vlerësimin e rrethanave që do të merren në konsideratë për marrjen ose rishqyrtimin e vendimit mbi caktimin e një mase edukuese ndaj të miturit, gjykatës ose prokurorit mund t'i vijë në ndihmë edhe Shërbimi i Provës, pasi në bazë të Rregullores së Shërbimit të Provës (2009) ky i fundit është i detyruar që me kërkesë të prokurorit ose gjykatës të paraqesë një raport vlerësues për personin nën hetim, për të pandehurin ose për të dënuarin në disa raste të caktuara. Të dhënat që paraqiten në këtë raport bazohen në

<sup>89</sup> V.Kamboski, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, 2007, f. 603.

<sup>90</sup> Duke pasur parasysh veçantinë e gjykimit të të miturve, në nenin 13, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale parashikohet se ky gjykim bëhet nga *seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore*, të përcaktuara me dekret të Presidentit. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, fillimisht me dekretin Nr.5351, datë 11.6.2007 “Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”, presidenti i Republikës dekretoi krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve, *pranë gjashtë gjykatave të rretheve gjyqësore* (Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë), të cilat do të shtrinin veprimtarinë e tyre edhe në rrethe të tjera gjyqësore të përcaktuara në këtë dekret. Më pas është shtuar edhe një seksion tjetër penal me dekretin Nr. 6218, datë 7.7.2009, “Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”, i cili shfuqizon dekretin e parë duke parashikuar krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve, pranë *shtatë gjykatave të rretheve gjyqësore*.

<sup>91</sup> Në datën 1.10.2007 me urdhër të posaçëm u miratua ngritja e seksioneve për të miturit në gjashtë prokurori të rretheve gjyqësore. (Open Society Foundation for Albania, *Raporti i Monitorimit të Shqipërisë në Procesin e Stabilizimit Asociimit* (1.10.2007-30.03.2008), f. 53, shih: <<http://www.soros.al/msa2008.pdf>>, aksesuar më 10.08.2010.

informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të tij. Një raportim i tillë nga një institucion i specializuar do të ishte shumë i vlefshëm veçanërisht në rastin e zgjerimit të llojeve të masave edukuese ndaj të miturve ndonëse në një situatë të tillë zgjidhja më e mirë do të ishte që në dispozitat përkatëse të KP/ligjit të posaçëm mbi masat edukuese (të reja) të parashikohet shprehimisht edhe roli i këtij Shërbimi në procesin e zgjedhjes së masës më të përshtatshme edukuese, sikurse ekziston tashmë në dispozitat e ndryshuara të KP mbi alternativat e dënimit me burgim.

#### 5.4 Caktimi i masës edukuese në Shqipëri

Në lidhje me kategorinë e të miturve që përjashtohen nga dënimi, statistikat tregojnë se neni 52 i KP nuk ka gjetur pothuajse aspak zbatim në praktikë dhe rrjedhimisht edhe masa edukuese ka ndjekur të njëjtën tendencë për këtë grup.<sup>92</sup> Ndërkohë, përsa i përket fëmijëve nën MMPP vihet re se në praktikën gjyqësore ekzistojnë disa raste, ndonëse të pakta në numër, të caktimit të masës edukuese në bazë të nenit 46 KP. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, në të cilën numri më i madh i të miturve të gjykuar rezultoi të jetë i një grupmoshe më të re se në rrethet e tjera,<sup>93</sup> nga studimi i praktikës gjyqësore vihet re se në pesë vitet e fundit (kryesisht në vitin 2006) ka patur disa kërkesa penale me objekt caktimin e masës edukuese të parashikuar në KP. Gjithashtu, rezultoi se për fëmijët, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur MMPP, minimumi i moshës së tyre në rastet kur është caktuar masë edukuese është 8 vjeç, ndërsa maksimumi i saj 13 vjeç. Ndërkohë, të gjithë fëmijët për të cilët prokurori ka paraqitur kërkesë për caktim të masës edukuese kanë qenë të gjinisë mashkullore. Lloji i veprës penale të kryer nga fëmija në të gjitha rastet ka qenë krimi i vjedhjes, në disa raste edhe në bashkëpunim ose më shumë se një herë. Problem shqetësues i evidentuar në vendime gjyqësore është edhe shtytja e fëmijës në krim nga persona të tjerë si dhe shfrytëzimi i moshës nën MMPP si rrethanë për t'iu shmangur përgjegjësisë penale. Ndërkohë, bashkëpunimi është shfaqur jo vetëm midis fëmijës dhe personave mbi MMPP, por edhe midis vetë fëmijëve nën MMPP. Institucioni i posaçëm i edukimit ku do të zbatohet masa edukuese e caktuar ndaj fëmijës në pothuajse të gjitha rastet nuk përcaktohet në vendimin gjyqësor. Përsa i përket rrethanave kryesore në bazë të të cilave është vendosur caktimi i masës edukuese, ato në përgjithësi kanë qenë: kryerja e një veprë penale relativisht të rëndë, kryerja e saj në bashkëpunim, si dhe përsëritja në kryerjen e veprimeve të kundërligjshme. Në vijim, në Tabelën 1 paraqiten në formë tabelore disa nga të dhënat

<sup>92</sup> Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri*, 2007, f.54.

<sup>93</sup> Sipas studimit të CRCA-së mbi drejtësinë për të miturit në Shqipëri në Gjykatën e Tiranës numri më i madh i të miturve të gjykuar i përket grupmoshës nën/në 16 vjeç (15-16 vjeç), ndërsa në rrethet e tjera i përket kryesisht grupmoshës mbi 16 vjeç (17-18 vjeç). (Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri*, 2007, f.30.)

ZBATIMI I MASAVE EDUKUESE TË KODIT PENAL NË SHQIPËRI

kryesore të studimit të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi kërkesat penale për caktim të masës edukuese, në periudhën Janar 2005-Korrik 2010.

**Tabela 1**

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	Janar-Korrik 2010
Numri i kërkesave penale për caktim të masës edukuese	0	15	3	0	0	0
Vendimi:						
1- Pranimi kërkesës	-	4	3	-	-	-
2- Pushim i gjykimit të kërkesës	-	11	0	-	-	-
Numri i fëmijëve ndaj të cilëve është caktuar masë edukuese	-	2	5	-	-	-
Mosha e fëmijës në kohën e kryerjes së veprës penale	-	10 12	8 9 10 12 13	-	-	-
Lloji i veprës penale të kryer nga fëmija	-	Vjedhje	Vjedhje Vjedhje e kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë	-	-	-
Përcaktimi i institucionit të edukimit në vendimin gjyqësor	- -	1	0	- -	- -	- -

Një rast veçanërisht problematik, për të cilin është vendosur disa herë masë edukuese nga Gjykata e Tiranës ka qenë rasti i djalit 12-vjeçar, S.S., endacak nga Korça, autor i dhjetra vjedhjeve në Tiranë, disa prej të cilave në vlera të konsiderueshme si dhe të kryera në bashkëpunim me persona të tjerë. Për këtë fëmijë vetëm në vitin 2006 janë paraqitur 14 kërkesa të njëpasnjëshme (3 të pranuar, për 11 të tjerat është vendosur pushimi i gjykimit të kërkesës si e panevojshme për shkak të konstatimit të ekzistencës së një

vendimi të mëparshëm për caktimin e masës ndaj të njëjtit person). Pas një viti prokurori ka paraqitur sërish kërkesë penale për caktimin e masës edukuese, e cila është pranuar nga gjykata. Ndërkohë nuk është bërë e mundur gjetja e tij dhe nga gjykata është deklaruar mosgjetja në të njëjtin vendim. Nga pjesa arsyetuese e vendimeve gjyqësore me objekt caktimin e masës edukuese ndaj S.S. rezulton se rrethanat e marra në konsideratë nga gjykata për marrjen e vendimit kanë qenë kryerja e krimit të vjedhjes, pranimi i këtij fakti nga vetë fëmija gjatë gjykimit, përsëritja e të njëjtit krim me dhjera herë, shfrytëzimi prej tij i moshës nën MMPP si rrethanë perjashtuese në kryerjen e krimeve, shtyrja në krim nga persona të tjerë, rreziku se moshja e tij nën MMPP mund të shfrytëzohet përsëri në të ardhmen nga persona të tjerë për të shtyrë në krim, fakti që fëmija ishte një endacak në Tiranë.

Një rast tjetër edhe më problematik i bërë publik edhe në media ka qenë rasti i djalit 13-vjeçar nga Berati, R.H., autor i dhunimit dhe vrasjes së një gruaje 47-vjeçare. Në këtë rast gjykata vendosi dërgimin e tij në një institucion edukimi, por për shkak të mungesës së këtij institucioni në Shqipëri R.H. mbeti në gjendje të lirë. Në këto kushte policia u detyrua të ndërmarrë një plan masash, edhe pse me kosto të rëndë për të, në bazë të të cilit R.H. do të mbahej nën mbikqyrje të plotë në distancë nga forcat e policisë, pasi gjashtë policë do të ndiqnin hap-pas hapi fëmijën që kishte kryer krimin e rëndë.<sup>94</sup> Ndërkohë, nuk mungoi edhe reagimi i vetë nënës së fëmijës, e cila deklaroi në media se do ta mbante djalin e saj të mbyllur në shtëpi.<sup>95</sup> Raste të tilla problematike kanë vënë edhe më tepër në pah vështirësitë e shfaqura gjatë zbatimit të nenit 46 të KP mbi masat edukuese, veçanërisht në lidhje me rastet serioze, me rrezikshmëri të madhe shoqërore të veprës dhe autorit, kur masa kërkohet të vendoset ndaj fëmijëve nën MMPP, për të cilët aktualisht masa edukuese institucionale mbetet një mundësi trajtimi në bazë të KP.

## 6. Rekomandime

Duke iu referuar standarteve ndërkombëtare mbi drejtësinë për të miturit dhe të drejtat e fëmijës, disa përfundimeve kryesore nga një vështrim krahasues i legjislacioneve përkatëse penale të vendeve të tjera në Europë, si dhe duke patur parasysh problematikat në lidhje me zbatimin e masës edukuese në Shqipëri disa rekomandime kryesore për përmirësime në lidhje me masën edukuese të parashikuar në KP shqiptar janë si më poshtë vijon:

- Dispozitat e Pjesës së Përgjithshme të KP lidhur me fëmijët-autorë të veprave penale, mundësisht të grupohen të paktën në një kre të veçantë të kësaj Pjese të KP, në të cilin të përfshihen edhe dispozita të reja të veçanta për masat edukuese

<sup>94</sup> Gazeta Shekulli, “Monstra i Beratit: Ç’do bëj kur të lirohem”, 09-01-2008.

<sup>95</sup> Po aty.

që do të mund të sqaronin apo shtonin elementë të domosdoshëm në lidhje me këto masa të zbatueshme për fëmijët që kryejnë vepra penale.

Përsa i përket llojeve të masave edukuese është e domosdoshme që:

- të shtohet larmishmëria e tyre duke parashikuar më shumë alternativa jo institucionale ose gjysmë-institucionale dhe vendosja në një institucion edukimi të jetë e parashikuar si masë e fundit. Gjithashtu, gjatë përcaktimit të llojeve të ndryshme të masave edukuese është e nevojshme;
- të theksohet edhe renditja e tyre sipas përparësisë në caktimin e tyre nga gjykata.

Legjislacionet përkatëse të vendeve të tjera në Europë, por edhe ato në rajonin e Ballkanit, të cilat prej vitesh tashmë njohin lloje të ndryshme të masave edukuese ndaj të miturve, ofrojnë një model të mirë për t'u marrë parasysh gjatë përcaktimit të llojeve të reja të masave edukuese.

Një zhvillim i tillë jo vetëm që do ta afronte legjislacionin shqiptar me standartet ndërkombëtare, por njëkohësisht do ta bënte këtë legjislacion edhe më bashkëkohor dhe në përshtatje edhe me zhvillimet dhe eksperiencën e deritanishme në Europë. Gjithashtu, zgjerimi i masave edukuese me lloje të reja i jep më shumë mundësi gjykatës që të zbatojë parimin e proporcionalitetit në përcaktimin e masës më të përshtatshme me personalitetin e fëmijës dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.

- Roli i masave edukuese në raport me dënimin penal për të miturit është e nevojshme që të përcaktohet si një rol parësor në dallim me atë sekondar që njihet aktualisht në KP. Në këtë kontekst, masat edukuese marrin një rol edhe më të rëndësishëm dhe kjo parashtron nevojën për një vëmendje dhe kujdes edhe më të madh gjatë shqyrtimit të mundësive apo opsioneve të lartpërmendura për përmirësime dhe shtesa në legjislacion. Synimi kryesor në përcaktimin e llojeve të masave edukuese duhet të jetë reflektimi i qëllimit pozitiv rehabilitues të sistemit të drejtësisë për të mitur, i mbështetur në Konventën për të Drejtat e Fëmijës.
- Kriteret kryesore që duhen marrë parasysh për caktimin e masave edukuese është e nevojshme të jenë të përcaktuara në KP, duke sanksionuar shprehimisht parimin e interesit më të lartë të fëmijës si kriter kryesor për procesin e caktimit të masës edukuese më të përshtatshme, si dhe parimin e proporcionalitetit.
- Zgjerimi i kategorive të personave ndaj të cilëve mund të zbatohen masat edukuese duke përfshirë edhe të rinjtë e moshës 18-21 vjeç, në bazë të kushteve dhe kufizimeve përkatëse të përcaktuara në ligj, bazuar në rekomandimet e Komitetit të Ministrave të KE-së, si dhe në detyrimin kushtetues për mbrojtje të veçantë edhe të të rinjve.



## ZBATIMI I MASAVE EDUKUESE TË KODIT PENAL NË SHQIPËRI

- Në lidhje me kategorinë e fëmijëve nën MMPP, ndaj të cilëve aktualisht në bazë të KP shqiptar mund të zbatohen masa edukuese, është e domosdoshme të merret parasysh edhe rekomandimi i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm Nr.10 (2007), sipas të cilit ndaj tyre mund të merren vetëm masa të veçanta mbrojtëse kur është e nevojshme në interesin e tyre më të lartë, si dhe praktikat më të mira të shteteve të tjera.
- Shtesat e mundshme në KP në lidhje me llojet e masave edukuese do të jetë e nevojshme të shoqërohen njëkohësisht edhe me ndryshime përkatëse në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, në të cilin rregullohet vënia në ekzekutim e masës edukuese.

## BIBLIOGRAFIA

### Literatura:

Avokati i Popullit, Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve në takimin me temë «Mbrojtja e fëmijëve, detyrim kushtetues dhe ligjor », Tiranë, 25 Tetor 2006.

Cavadino, M., dhe Dignan, J., *The penal system, an introduction*, Third edition, SAGE publications, 2003.

Cipriani, D., *Children's rights and the minimum age of criminal responsibility: a global perspective*, Ashgate Publishing Limited, England, 2009.

Commission of the European Communities, *Albania 2009 Progress Report*

Committee of Ministers of the Council of Europe, Recommendation CM/Rec(2008)11 of the Committee of Ministers to member states on the European Rules for juvenile offenders subject to sanctions or measures (Adopted by the Committee of Ministers on 5 November 2008).

Committee of Ministers of the Council of Europe, *Recommendation Rec(2003)20 of the Committee of Ministers to member states concerning new ways of dealing with juvenile delinquency and the role of juvenile justice* (Adopted on 24 September 2003)

Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 "Children's rights in juvenile justice"* (CRC/C/GC/10), 2007.

Consultative Council of European Prosecutors (CCPE), *Questionnaire on principles of public prosecution as regards juvenile justice*, Strasbourg, 2009.

CRCA/ DCI Albania, *"Situata e të miturve në konflikt me ligjin"* (2009).

Cvjetko, B., *Criminal responsibility of minors in the Republic of Croatia*, International Review of Penal Law (Vol. 75) ,f.265.

Defence for Children International, *"From legislation to action?-Trends in Juvenile Justice systems across 15 countries"*, Geneva, 2007.

Dekreti Nr.6218, datë 7.7.2009, "Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore"

Elezi I., Kaçupi S., Haxhia M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Ribotim, West Print, Tiranë, 2009.

Elezi,I., Hysi, V., *Politika Kriminale*, PEGI, 2006.

Hysi, V., *Penologjia*, PEGI, Tiranë, 2006.

Kambovski, V., *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup 2007.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, *Sistemi i drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri-Reflektime mbi të tashmen dhe të ardhmen e tij*, Tiranë, 2005.

Muçi, Sh., *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2007.

Peza, N., Elezi, I., Gjika, G., Dumi, D., Çela, A., *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Pjesa e Përgjithshme)*, Shtëpia botuese "8 Nëntori", 1982.

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara me mbështetjen e Save the Children in Albania, *Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës-Studim Krahasues*, 2007.

Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri- Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri*, ViSi Design, Tiranë, Qershor 2007.

Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri- Një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri*, ViSi Design, Tiranë, 2007.

*Raporti fillestar kombëtar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës*, i paraqitur nga Shqipëria në Komitetin për të drejtat e fëmijës të OKB-së, Sesioni 38, CRC/C/11/Add.27, 5 July 2004, si dhe Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës: Shqipëria, sesioni 38(CRC/C/15/Add.249), 28 Janar 2005.

UNICEF, Regional Office for CEE/CIS, *Evaluation of UNICEF's contribution to Juvenile Justice System Reform*, Final Evaluation Report, March 2007.

*Burime ligjore:*

Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar.

Kodi Penal i Malit të Zi

Kodi Penal i Sllovenisë

Kodi Penal i vitit 1928

Kodi Penal i vitit 1977 dhe ndryshimet përkatëse

Kodi Penal i vitit 1995, i ndryshuar.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 20 nëntor 1989.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligj penal për të mitur i Kosovës

Ligji kroat për Gjykatat e të miturve

Ligji Nr.8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar.

Rregullat Standarte Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 40/33, 29 Nëntor 1985 (Rregullat e Pekinit).

Rregullorja "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", miratuar me VKM nr.302, datë 25.3.2009.

Strategjia Kombëtare për fëmijët 2006-2010, miratuar me VKM nr. 368, datë 31.05.2005, si dhe Plani i Veprimit.

Vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi kërkesat penale me objekt caktimin e masës edukuese, Janar 2005-Korrik 2010.

**THE EDUCATIONAL MEASURES PROVIDED BY THE PENAL CODE AND  
THEIR APPLICATION IN ALBANIA**

The educational measures provided by the Albanian Penal Code may be imposed on juveniles (minors) only when they are exempted from criminal punishment for the committed criminal offence and also on children below the age of criminal responsibility at the time of the commission of the offence. According to Article 46 of this Code the court may impose only one educational measure that is an institutional measure consisting in the placement of the child or juvenile to a special educational institution.

This paper analyzes the characteristics of the educational measure provided by the Albanian Penal Code in historical context, in comparison to the relevant penal legislation of other European and regional countries and referring to the international instruments on the rights of the child while also considering the main issues in relation to the application of the educational measure in Albania. It concludes with recommendations on some important improvements needed such as the stipulation of educational measures in at least a special chapter in the General Part of the Albanian Penal Code that would focus on juvenile offenders and among other issues related to juveniles would specify the characteristics and rules of imposition and supervision of implementation for educational measures. In such provisions the institutional measure currently provided in this Code would become an exception and a measure of last resort among a variety of educational measures applicable to juveniles and this variety would insure the applicability of the principle of proportionality in the process of selecting the most appropriate and effective measure.

Other relevant issues include providing the main criteria that Albanian domestic courts should consider when imposing an educational measure, where the best interests of the child should be the primary consideration; changing the role of educational measures for juveniles in relation to criminal punishment from secondary, as currently provided, to primary role (giving preference to educational measures); taking into consideration in accordance with the recommendations of the Committee of Ministers of the Council of Europe, the possibility of extending the applicability of the special provisions for juveniles, where appropriate, for young adult offenders under the age of 21; concerning children below the age of criminal responsibility, it is necessary to take into account the recommendation of the Committee on the Rights of the Child that for these children only special protective measures can be taken if necessary in their best interests.